

NJOFTIM STATISTIKOR
BILANCI I PAGESAVE

BILANCI I PAGESAVE¹

Përmbajtja

Llogaria korrente	2
Tregtia e mallrave	3
Tregtia e shërbimeve	3
Të ardhurat dytësore	4
Të ardhurat dytësore	5
Llogaria kapitale	5
Llogaria financiare	5

Kryesore:

Në tremujorin e katërt të vitit 2023:

- Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 232 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë me 51%;
- Llogaria e shërbimeve vlerësohet në një balancë pozitive prej rreth 752 milionë euro, me rritje në terma vjetorë;
- Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 402 milionë euro, në rritje vjetore me 4%;
- Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 252 milionë euro;
- Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 7.3 muaj importe në mallra dhe shërbime.

Në tremujorin e katërt të vitit 2023, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi pozitiv, në rritje të mjetëve të rezervës valutore, prej rreth 151 milionë euro.

Deficiti i llogarisë korrente shënon 232 milionë euro, i ngushtuar në terma vjetorë me rreth 241 milionë euro (ose 51%), në sfondin e zgjerimit të suficitit tregtar në shërbime.

Ecuria e deficitit korrent, gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023, vëren zgjerim të ndjeshëm të suficitit tregtar të shërbimeve të udhëtimit, rritje të të ardhurave nga shërbimet e tjera biznesi dhe nga ato për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët. Njëkohësisht, balancat negative të të ardhurave (parësore) nga investimet si dhe deficiti tregtar në mallra janë ngushtuar.


Llogaria kapitale u mbyll me një fluks neto negativ prej 50 milionë euro, kundrejt fluksit neto pozitiv prej 23 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Periudha regjistroi flukse të konsiderueshme dalëse nga sektori privat.

Shkalla e ekspozimit² të ekonomisë shqiptare vlerësohet në -282 milionë euro kundrejt nivelit prej -450 milionë euro në të njëjtën periudhë në vitin e kaluar.

Flukset hyrëse në llogarinë kapitale dhe financiare (pa përfshirë mjetet e rezervës) shënojnë 319 milionë euro dhe mundësojnë plotësisht mbulimin e deficitit korrent.

Në një total prej rreth 369 milionë euro (pa përfshirë mjetet e rezervës) flukset hyrëse neto në llogarinë financiare, reflektojnë kryesisht zgjerimin e detyrimeve neto në formën e investimeve direkte (346 milionë euro) dhe të investimeve të tjera (327 milionë euro), ndërkohë që investimet e portofolit rezultuan në flukse neto dalëse, në rreth 304 milionë euro.

Rezerva valutore, në fund të dhjetorit 2023, shënon 5,847 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 7.3 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime dhe rreth 516% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.



Grafik 1. Llogaria korrente dhe flukset financiare neto (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve). Shënim: Flukset financiare neto paraqiten sipas parimit të drejtimit të investimit.

1. Të dhënat janë hartuar bazuar në metodologjinë e FMN "Manuali i Bilancit të Pagesave, Botimi i 6-të". Bilanci i Pagesave (BP) regjistron të gjitha transaksionet ekonomike të ndodhura midis njëzive rezidente dhe jorezidente, gjatë një periudhe të dhënë kohe.
2. Bilanci i llogarisë korrente së bashku me bilancin e llogarisë kapitale përcakton shkallën e ekspozimit të ekonomisë shqiptare me pjesën tjetër të botës, ndërsa llogaria financiare shpjegon si është financiar ky ekspozim.
3. Alokimi i SDR është një mënyrë për të plotësuar rezervat valutore të vendeve anëtare të Fondit, duke i lejuar anëtarët të zvogëlojnë varësinë e tyre në borxhin e brendshëm ose të jashtëm për ndërtimin e rezervave. Shqipëria ka përfutur nga alokimi i SDR nga viti 2009.

LLOGARIA KORRENTE

Gjatë tremujorit të katërt 2023, transaksionet korrente u zgjeruan me rreth 17% në terma vjetorë, në një nivel prej rreth 5,538 milionë euro. Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në 232 milionë euro, në përmirësim me rreth 51% në terma vjetorë.

Përmirësimi i llogarisë korrente në masë të konsiderueshme u ndikua nga zgjerimi i suficitit tregtar në shërbime, i shoqëruar me ngushtim të deficitit tregtar në mallra dhe të balancës negative të të ardhurave parësore.

Deficiti tregtar në mallra u ngushtua me rreth 18 milionë euro në terma vjetorë, në reflektim të përmirësimit të bilancit tregtar në “produkte minerale”, që ka kompensuar plotësisht përkeqësimin e bilanceve tregtare kryesisht në grupmallrat “mjete transporti”, dhe “ushqime të përgatitura, pije alkolike, duhan”.

Në terma vjetorë, suficiti tregtar në shërbime u zgjerua me 40% në nivelin 752 milionë euro, ku shërbimet e udhëtimit, shërbimet e tjera biznesi, shërbimet e transportit si dhe shërbimet për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët, zgjeruan ndjeshëm balancat e tyre pozitive.

Të ardhurat parësore (puna dhe kapitali) rezultojnë me një balancë negative prej rreth 86 milionë euro, kundrejt 96 milionë euro në të njëjtën periudhë në vitin e kaluar. Të ardhurat nga investimi (kthimit nga kapitali) zgjeruan balancën negative me rreth prej rreth 20 milionë euro, Ndërkohë, flukset neto hyrëse të të ardhurave nga puna janë rritur me +28 milionë euro.

Gjatë periudhës, rreth 88% e shpenzimeve korrente⁴ kanë shkuar për financimin e importit të mallrave dhe shërbimeve. Ndërkohë, hyrjet valutore⁵ janë siguruar kryesisht nga eksporti i shërbimeve (në masën 59%), si dhe nga eksporti i mallrave dhe transfertave të njëanshme drejt sektorit privat (sëbashku në rreth 33%).

Në tremujorin e katërt 2023, përmirësimi i deficitit korrent është ndikuar kryesisht nga zgjerimi i suficitit tregtar në shërbime

	Të dhëna kumulative (4-mujore) për fundin e periudhës, në milionë euro							
	T4 2022			T4 2023			T4 2022	T4 2023
	Bilanci	Kredi	Debi	Bilanci	Kredi	Debi	Bilanci	Bilanci
Llogaria korrente	- 1,063	8,611	9,674	- 191	10,620	10,810	- 472.8	- 232.1
<i>në përfaqësimin ndaj PBB</i>	-6%	48%	54%	-1%	50%	51%		
Mallra	- 4,269	1,933	6,201	- 4,540	1,836	6,376	- 1,239	- 1,221
Shërbime	2,401	4,801	2,400	3,431	6,645	3,214	539	752
Shërbime për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët	625	625	0	770	771	1	152	178
Transport	205	507	302	320	713	393	43	69
Udhëtime	1,069	2,840	1,771	1,838	4,173	2,335	226	376
Shërbime telekomunikacioni, kompjuteri dhe informacioni	96	156	60	85	198	113	27	30
Shërbime të tjera biznesi	398	494	96	389	535	146	88	121
Shërbime dhe mallra qeveritare	10	54	44	11	48	37	3	3
Shërbime të tjera	- 2	125	127	17	206	188	5	- 24
Të ardhura parësore	- 315	597	912	- 278	771	1,050	- 93	- 86
Të ardhura nga puna	428	456	28	535	571	36	117	145
Të ardhura nga investimet	- 745	133	878	- 813	191	1,004	- 210	- 230
Investime direkte	- 682	69	751	- 769	60	829	- 179	- 210
Investime portofoli	- 7	41	48	15	53	39	- 19	- 8
Investime të tjera	- 73	6	79	- 120	17	136	- 19	- 33
Mjetet e rezervës	17	17	-	61	61	-	8	21
Të ardhura të tjera parësore	2	8	6	0	9	10	0	0
Të ardhura dytësore	1,119	1,280	161	1,197	1,368	171	321	322
Të ardhura nga emigrantët	834	834	-	928	928	-	242	252

Tabela. Ecuria e përbërësve të bilancit të pagesave (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)

⁴ Shpenzimet korrente përfshijnë importin e mallrave, importin e shërbimeve, daljet në të ardhurat dytësore dhe daljet në të ardhurat dytësore.

⁵ Hyrjet valutore përfshijnë eksportin e mallrave, eksportin e shërbimeve, hyrjet në të ardhurat dytësore dhe hyrjet në të ardhurat dytësore.




TREGTIA E MALLRAVE

Vëllimi i përgjithshëm i tregtisë në mallra u zgjerua me 3% në terma vjetorë, në nivelin 2,229 milionë euro. Tregtia në mallra përfaqëson rreth 40% të transaksioneve korrente. Sëbashku, importi dhe eksporti i mallrave u zgjeruan respektivisht me 9% dhe 1% në terma vjetorë. Të hyrat nga eksportet shënuan 504 milionë euro ose 40 milionë euro më shumë se në të njëjtin tremujor të vitit të kaluar. Rritja me e madhe është vërejtur në eksportet e “metaleve bazë”.

Importi i mallrave shënon 1,725 milionë euro nga 1,703 milionë euro, në tremujorin e katërt 2022. Gjatë tremujorit, shpenzimet në importet e grupmallrave “mjete transporti” “metale bazë”, dhe “ushqime të përgatitura, pije alkolike”, janë rritur në përgjigje të kërkesës së brendshme. Ndërkohë, importet në “produkte minerale” dhe “makineri e pajisje mekanike dhe elektrike” regjistruan rënie.

Deficiti tregtar në mallra shënon 1,221 milionë euro, lehtësisht i ngushtuar në terma vjetorë me rreth 1.4%. Shkalla e mbulimit të importeve nga eksportet vlerësohet në nivelin 29% nga 27% në një vit më parë.



Grafik 2. Ecuria e tregtisë në mallra (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Deficiti i tregtisë në mallra u ngushtua me 18 milionë euro dhe shënon 1,221 milionë euro

TREGTIA E SHËRBIMEVE

Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve u mbyll me një balancë pozitive, prej rreth 752 milionë euro, e zgjeruar në terma vjetorë me rreth 40%.

Vëllimi i transaksioneve tregtare në shërbime u rrit me rreth 39% në terma vjetorë, ndikuar nga shërbimet e udhëtimit dhe ato të transportit, në reflektim të zgjerimit të konsiderueshëm të numrit të udhëtarëve të huaj në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, zgjerim të balancave pozitive kanë shënuar kategoritë e shërbimeve të tjera biznesi dhe shërbimet për përpunim të inpueteve fizike të zotëruara nga të tjerët.

Shërbimet e udhëtimit u mbyllën me suficit prej 376 milionë euro, kundrejt atij prej 226 milionë euro një vit më parë. Të ardhurat dhe shpenzimet nga shërbimet e udhëtimit u rritën në terma vjetorë respektivisht me rreth 48% dhe 38%. Kjo ecuri është kryesisht pasojë e rritjes së fluksit të udhëtarëve.

Gjatë tremujorit të katërt 2023, eksporti i shërbimeve të udhëtimit i ka siguruar ekonomisë vendase rreth 958 milionë euro. Nga ana tjetër, udhëtarët rezidentë (shqiptarë dhe të huaj) kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë vendit 582 milionë euro.

Shërbimet e udhëtimit gjenerojnë respektivisht 61% të flukseve valutore në hyrje dhe rreth 72% të shpenzimeve të kategorisë së shërbimeve.



Shërbime të tjera biznesi rezultuan me bilanc pozitiv prej 121 milionë euro, në rritje vjetore prej 37%. Kjo kategori shërbimi i ka sjellë ekonomisë shqiptare flukse valutore hyrëse prej rreth 160 milionë euro, gjatë tremujorit të katërt.

Shërbimet e transportit kanë zgjeruar balancën pozitive me rreth 25.8 milionë euro.

Bilanci pozitiv i shërbimeve për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët⁶ u vlerësua në 178 milionë euro. Flukset valutore hyrëse të kësaj kategorie u zgjeruan në terma vjetorë me 17% në nivelin 178 milionë euro dhe përfaqësojnë shërbime që ekonomia shqiptare i ofron partnerëve të huaj (jorezidentëve) për përpunimin e mallrave të zotëruara prej këtyre të fundit.

TË ARDHURAT PARËSORE


Llogaria e të ardhurave parësore (puna dhe kapitali) u mbyll me balancë negative prej 86 milionë euro. Flukset hyrëse dhe dalëse, të kësaj kategorie të ardhurash, u rritën respektivisht me 24% dhe 13% kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të kaluar.

Të ardhurat neto faktoriale nga puna, të cilat kryesojnë flukset hyrëse të të ardhurave parësore, rezultuan në një fluks neto pozitiv prej 145 milionë euro ose 24% më shumë se në të njëjtën periudhë një vit më parë. Rritja i dedikohet në masën më të madhe rritjes së numrit të punonjësve sezonalë dhe kufitarë jashtë vendit.

Të ardhurat neto nga investimet thelluan balancën negative, në nivelin 230 milionë euro, ose 10% më shumë kundrejt tremujorit të katërt të 2022. Investimet direkte mbizotërojnë, si instrument, flukset valutore neto nga investimi. Këtë tremujor, fluksi dalës neto në formën e fitimit të riinvestuar⁷ shënon 226 milionë euro nga 200 milionë euro në një vit më parë.

Ndërkohë, pagesat e interesave për huatë shënojnë 63 milionë euro nga 57 milionë euro në një vit më parë (prej të cilave rreth 24 milionë euro janë interesa të paguara nga qeveria e përgjithshme për llogari të eurobondit të mbajtur nga jorezidentët).

Të ardhurat nga puna kanë diktuar ecurinë e ngushtimit të balancës negative të të ardhurave parësore



Grafik 3. Ecuria e të ardhurave parësore nga investimet (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

⁶ Këtu përfshihet vëllimi i transaksioneve të kryera nga industria e përpunimit me lëndë të dytë të huaj në vend.


⁷ Konform standardit metodologjik—parimit të regjistrimit të dyfishtë të transaksionit, zëri "fitim i riinvestuar", si komponent i investimeve direkte në llogarinë financiare, duhet të regjistrohet edhe në llogarinë e të ardhurave dytësore nga investimet. Ky regjistrim kryhet në masë të njëjtë, por në kahe të kundërta.



TË ARDHURAT DYTËSORE

Të ardhurat dytësore u vlerësuan në 322 milionë euro. Rreth 78% e të ardhurave dytësore përfaqësohet nga “të ardhurat nga emigrantët”.

Prurjet valutore të emigrantëve, shënuan rreth 252 milionë euro, në rritje vjetore (4%). Gjatë periudhës, është vërejtur rritje e dërgesave në formën e prurjeve në cash, atribut i ardhjes së emigrantëve gjatë periudhës së fundvitit.



Grafik 4. Ecuria e të ardhurave dytësore dhe të ardhurat nga emigrantët (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Për tremujorin e katërt të vitit 2023, prurjet valutore nga emigrantët vlerësohen në rreth 252 milionë euro

LLOGARIA KAPITALE

Për tremujorin e katërt të vitit, llogaria kapitale u mbyll me një fluks neto negativ prej - 50 milionë euro, kundrejt fluksit neto pozitiv 23 milionë euro një vit më parë. Flukset hyrëse në llogarinë kapitale u vlerësuan në 132 milionë euro, ndërsa flukset dalëse në 182 milionë euro. Kjo ecuri është diktuar nga rritja e transfertave dalëse të sektorit privat.

LLOGARIA FINANCIARE

Llogaria financiare (pa përfshirë mjetet e rezervës) rezultoi në një fluks hyrës neto prej rreth 369 milionë euro, krahasimisht me fluksin hyrës prej 287 milionë euro, të regjistruara në të njëjtën periudhë në 2022.

Flukset hyrëse neto në llogarinë financiare, reflektojnë kryesisht zgjerimin e detyrimeve neto në formën e investimeve direkte (prej rreth 346 milionë euro) dhe të investimeve të tjera (prej rreth 327 milionë euro), ndërkohë që investimet e portofolit rezultuan në fluks neto dalës (prej rreth 304 milionë euro).


Flukset hyrëse jo borxh krijuese në formën e investimeve të huaja direkte shënuan 417 milionë euro, në rritje vjetore rreth 9%. Më tej, marrëdhëniet e borxhit mes kompanive të lidhura nën një marrëdhënie të investimit direkt, rezultuan me një fluks dalës, prej - 15 milionë euro (shlyerja e detyrimeve si instrument borxhi mes kompanive të lidhura).

Për tremujorin e katërt të vitit, investimet e huaja direkte u vlerësuan në 402 milionë euro, me rritje rreth 4% në terma vjetorë. Injektimi me kapital të ri shënoi 191 milionë euro, në rritje vjetore rreth 4%. Ndërkohë që, kategoria fitimi i riinvestuar u zgjerua me 13%, në nivelin 226 milionë euro.




Gjatë tremujorit të katërt 2023, flukset valutore hyrëse në formën e *investimeve të huaja direkte* ishin të përqendruara kryesisht në pasuri të paluajtshme (në masën 26%), sektorin e ndërmjetësimit financiar (në masën 17%), e hidrokarbureve (në masën 16%), e energjitikës (në masën 10%), si dhe komunikacionit (në masën 4%).

Në të njëjtën kohë, zotërimet tona jashtë - mjetet financiare në formën e *investimeve direkte jashtë* u zgjeruan me 56 milionë euro, ose 12 milionë euro më shumë referuar të njëjtës periudhë një vit më parë.



Grafik 5. Llogaria financiare dhe flukset neto sipas kategorive përbërëse (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)

Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 402 milionë euro, me rritje rreth 4% në terma vjetorë




Grafik 6. Ecuria e fluksit të investimeve direkte - mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)

Investimet e portofolit rezultuan në një fluks neto dalës prej 304 milionë euro. Ecuria është kryesisht rrjedhojë e zgjerimit të zotërimeve jashtë të sektorit të *korporatave depozituese* në letra me vlerë të borxhit (me 173 milionë euro). Në të njëjtën kohë, qeveria e përgjithshme ka ulur ekspozimin me jashtë në letra me vlerë të borxhit (Eurobond) - me rreth 142 milionë euro, përmes blerjes mbrapsht të borxhit ekzistues.

Llogaria *investimet e tjera* u mbyll në një fluks neto hyrës prej 327 milionë euro. Sërish zhvillimi i atribuohet sektorit të *korporatave depozituese* në kuadër të strategjisë së investimit, që ka rezultuar në zhvendosje të zotërimeve nga “*monedha dhe depozita*” (rreth 135 milionë euro) në *letra me vlerë të borxhit* (shih paragrafin më sipër).

Në kahun e detyrimeve, *qeveria e përgjithshme* ka zgjeruar detyrimet në formën e *huasë* me rreth 139 milionë euro. Sektori i *korporatave depozituese* ka rritur ekspozimin në *huamarrije* prej 42 milionë euro, dhe në të njëjtën kohë ka rritur detyrimet në “*monedha dhe depozita*” prej 33 milionë euro.





Grafik 7. Ecuria e fluksit të investimeve të portofolit dhe investimeve të tjera – mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Gjatë tremujorit të katërt 2023, mjetet e rezervës u rritën me 151 milionë euro. Rezerva valutore në fund të periudhës shënon 5,847 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 7.3 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime.

Rezerva valutore në fund të periudhës vlerësohet mjaftueshëm për mbulimin e 7.3 muaj importe mesatare vjetore në mallra e shërbime



**DEPARTAMENTI I
STATISTIKAVE
FINANCIARE**

Selia Qendrore Nr. 1 e Bankës së
Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1,
Tiranë

Tel: + 355 4 241 93 01
+ 355 4 241 93 02
+ 355 4 241 93 03
+ 355 4 241 94 09
+ 355 4 241 94 10
+ 355 4 241 94 11

Fax: + 355 4 241 94 08
Email: statistics@bankofalbania.org



Shënime:

Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të bërë rishikimin e statistikave të publikuara. Në rastin e rishikimeve që sjellin ndryshime të treguesve, Banka e Shqipërisë njihë përdoruesit me faktorët e rishikimit dhe ndikimin përkatës.

Gjatë periudhës kanë ndodhur ndryshime në bilancin e pagesave, si pasojë e rishikimeve, pasojë e plotësimit të informacionit me të dhëna nga njësitë raportuese.

Është rishikuar seria kohore T1/2023-T3/2023, bazuar në politikën e rishikimit të Bankës së Shqipërisë.

Për më shumë informacion mbi të dhënat e bilancit të pagesave referojuni linkut të mëposhtëm:

https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/Bilanci_i_Pagesave/Te_dhenat_kryesore_per_Bilancin_e_Pagesave.html